

BREAKING NEWS

“NUK KA NDODHUR QË NGA VDEKJA E GJERGJ KASTRIOT SKËNDERBEUT”, SPARTAK NGJELA



AKTUALITET

Ishin në kërkim për plagosje, kanosje dhe armëmbajtje pa leje, arrestohen 4 persona në Lezhë, Tiranë dhe Durrës

SHKRUAR NGA ALBIONA LIPO
18 NËNTOR 2020



Vetëm gjatë 24 orëve të fundit policia ka bërë të mundur arrestimin e 4 personave të shpallur në kërkim për plagosje, kanosje dhe armëmbajtje pa leje në qytetet Lezhë, Tiranë dhe Durrës. Gjatë kontrolleve të ushtruara nëpër banesa policia ka konstatuar edhe një rast të veprës penale “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike” në qytetin e Lezhës, për të cilën është arrestuar një person. Fillimisht policia njofton se në pranga ka rënë një 50-vjeçar nga Kamza pasi ka qenë i shpallur në kërkim dhe i dënua me dy vite burg për “Armëmbajtje pa leje”. Ndërsa një 30-vjeçar nga Mirëdita është arrestuar pasi në banesë i është gjetur një armë zjarri automatik. “Shërbimet e Policisë Mirditë, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr. 5 Tiranë, në vijim të punës për kapjen e personave në kërkim dhe vënien e tyre para përgjegjësisë penale, mbi bazën e informacioneve të siguruara në rrugë operative, bënë të mundur lokalizimin, kapjen dhe ndalimin e shtetasit Dritan Arapi, 50 vjeç, banues në Kamzë, të cilin Gjykata e Apelit Shkodër, në vitin 2019, e ka dënua me 2 vite burg, për veprën penale “Armëmbajtja pa leje”. Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Mirditë, në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë në fushën e armëmbajtjes pa leje, arrestuan në flagrancë shtetasin A. Gj., 30 vjeç, banues në Kurbnesh, Mirditë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar nga shërbimet e Policisë në lokalin e tij u gjet dhe u sekuestrua një armë zjarri automatik”, deklaroi policia. Kalvarit të personave të arrestuar i është shtuar edhe një 23-vjeçar pasi gjatë kontrollit fizik i janë gjetur një sasi lëndë kanabisi. “Gjithashtu, shërbimet e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me forcën e posaçme “Shqiponja” të DVP Lezhë, mbi bazën e informacioneve se shtetasi A. V., 23 vjeç, banues në Shëngjin, kryente veprime në kundërshtim me vendimin e Gjykatës, ndërkohë që ishte me masë sigurie “Arrest në shtëpi”, kanë ushtruar kontrolle në një lokal në Shëngjin, ku kanë konstatuar shtetasin A. V., të cilit gjatë kontrollit fizik iu gjet dhe u sekuestrua një sasi lëndë narkotike e dyshuar cannabis sativa”, deklaroi policia.


Dy të arrestuar në Tiranë

Ndërkohë, në qytetin e Tiranës gjatë ditës së djeshme janë arrestuar 2 persona, një 31-vjeçar dhe një 20-vjeçar, të cilët kanë qenë të shpallur në kërkim për veprat penale “Kanosje” dhe “Vjedhja”. “Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Nr.4, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr. 2, kapën dhe ndaluan shtetasin E. G., 31 vjeç, i shpallur në kërkim për veprat penale “Kanosja” dhe “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”. Po nga specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Nr.4, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr. 3, u kap dhe u ndalua shtetasi F. O., 20 vjeç, i shpallur në kërkim për veprën penale “Vjedhja”. Gjithashtu, nga veprimet ka rezultuar se ky shtetas, më datë 05.11.2020 i ka vjedhur telefonin shtetasit G. Sh. dhe më datë 13.11.2020 i ka vjedhur telefonin shtetasit G. N”, deklaroi policia.


Në Durrës arrestohet një 26-vjeçar

Gjithashtu, Policia e Durrësit ka ndaluar dje një 26-vjeçar të shpallur në kërkim kombëtar pasi më datë 21.05.2020, në Fushë-Krujë, ka plagosur me mjet prerës (thikë), për motive të dobëta, personin S. T. dhe E. Gj. “Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Krujë, në vijim të punës për kapjen e personave në kërkim dhe vënien e tyre para përgjegjësisë penale, ndaluan shtetasin B. X., 26 vjeç, banues në fshatin Nua, Krujë, pasi Gjykata e Shkallës së Parë Krujë i ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprat penale “Plagosja e rëndë me dashje” dhe “Mbajtja pa leje e armëve të ftohta”. Ky shtetas, më datë 21.05.2020, në Fushë Krujë, ka plagosur me mjet prerës (thikë), për motive të dobëta, shtetasit S. T. dhe E. Gj”, deklaroi policia.


Më të lexuarat




“Për dy javë zhduket koronavirusi nga planeti”, kura që duhet përdorur sipas Ruzhdi Metalit, befasohet Arjan Çani




Karantinë të dytë apo mbyllje të shkollave? Kryemadhi befason me përgjigjen: Jam pro...




Situata e COVID-19/ Analisti bën deklaratën e fortë: Do na mbyllin 2-3 javë para festave!




EMRI/Pedagogia e njohur infektohet me COVID-19




“Kanë dëgjuar që janë 3-4 veta në një dhomë dhe infermieri të shikon njëherë në 6 orë”, mjeku i njohur shqiptar jep mesazhin e fortë: Ja çfarë po ndodh në spitalet Covid




Oficeri i policisë vdiq nga Covid-19 te Infektiv, bashkëshortja bën denoncimin e fortë: I janë marrë...




Kukësi i hoqi titullin e nderit, reagon për herë të parë Veton Surroi: Është një lajm në zhvillim! Ju tregoj se çfarë fshihet pas këtij vendimi




Situata e COVID, mjeku Alimehmeti zbulon cila është masa më me impakt në vendin tonë




Thanë se 22-vjeçarin në Bulqizë e qëlloi pakujdesisht shoku i ngushtë, policia zbardh detajet tronditëse që bëjnë kthesën e madhe të ngjarjes



Aksident në Fushë-Krujë, ka të plagosur (Detajet e para)



‘Kërkesa për vaksinën e gripit është 4-fishuar’, ekspertja e ISHP apel qytetarëve: Duhet të bëni çmos të mos ...



Agron Gjekmarkaj bën parashikimin e fortë: Ju tregoj se çfarë do të ndodhë me partitë e reja në zgjedhjet e 25 prillit

Mesazhe Promocionale

Gossip



rja e njohur e shfaqet ndryshe herë tjetër dhe na gjithëve: Hera e jetën time me...

gjithmonë sensuale në rrjete herë ...

Plas she Channel fizikisht

Një tjetër sher në "Hell's Kitc..

Opinione



PANDELI BARDHI

Dijet dhe dijetarët nëpër rrugë dhe trotuare.....



BESI BEKTESHI

Propaganda korruptive me paratë e taksave si “i...



GJON NEÇAJ

Politikanë, a e kuptoni se virtyti mbart shpres...



SEVO TARIFA

Duke jetuar ditë të bardha, s'duhen harruar di...

LEXO OPINIONE TE TJERA